

05 2938
1 12.03.20



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit/Ministarstvo Infrastrukture i Sredine

Ministry of Infrastructure and Environment

DATË/A:	12.03.2020
REFERENC-Ë:	031/427
PËR/ZA/TO:	Operatorët e transportit rrugor të udhëtarëve të licencuar nga MIA-ja Shoqatën e Operatorëve të transportit Rrugor të udhëtarëve me autobus Stacioneve të autobusëve dhe
PËRMES/THROUGHT/PREKO	
Cc:	z.Lumir Abdixhiku, Ministër z.Izedin Bytyqi, Sekretar i Përgjithshëm
NGA/OD/FROM:	z.Xhemë Veseli, Drejtor i Departamentit të Transportit Tokësor
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për zbatimin e vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 01/07 datë 11.03.2020

Të nderuar,

Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur me datën 11.03.2020 ka nxjerrë vendimin nr. 01/07 me qëllim të parandalimit të infeksionit *Corona Virus (COVID-19)* ka miratuar një mori të masave, andaj në këtë kontekst kërkojmë nga të gjithë operatorët e transportit të licencuar nga MIA-ja që ushtrojnë veprimtarinë e transportit ndërkombëtarë , nder urban , po ashtu edhe stacionet e autobusëve të cilat ofrojnë shërbime të transportit për operatorët e transportit të ndërmarrin masat në zbatim të këtij vendimi respektivisht pika 1.9:

- Të gjitha ndërmarrjet publike dhe kompanitë private që kryejnë transport publik të udhëtarëve , obligohen të bëjnë dezinfektim të rregullt të mjeteve transportuese.
- Obligohen të gjithë operatorët që ushtrojnë veprimtarinë e transportit që të zbatojnë vendimin e Qeverisë në një afat të menjëhershëm dhe në mënyrë permanente.
- Operatorët duhet të mbajnë dëshminë konkrete në automjet (autobus) mbi dezinfektimin e mjetit.

Me respekt!